

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.M. nga fsh. ..., Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur për ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av. F.A., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR në Gjilan, PKR.nr.247/2017 të dt. 10.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, me datë 08.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit N.M., ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Gjilan, PKR.nr.247/2017 të dt. 10.09.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore - DKR në Gjilan, me aktgjykimin PKR.nr.247/2017 të dt. 10.09.2018, e ka shpallur fajtor të akuzuarin N.M., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, dhe për këtë vepër penale e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €, të cilin dënim do ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi, në të kundërtën dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë me dënim burgu, ashtu që për një ditë burgim do t'i llogaritet shuma prej 20 €.

Të akuzuarit i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues, ashtu që nga i akuzuari ka konfiskuar armën e zjarrit të tipit-pushkë M-48, e prodhimit rus me numër serik 1622, si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

Të akuzuarin e ka detyruar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të shumës së paushallit gjyqësor, shumën prej 40 (katër dhjetë) €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit N.M., av. F.A., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje, gjobë apo edhe i kushtëzuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e mbajti konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, pa informimin e palëve, ngase, nuk ka bazë ligjore për informim të obligueshëm të palëve.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/I.nr.480/2018, të dt. 12.10.2018, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar

Pretendimet ankimore përkitazi me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.M. av. F.A., në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së, ngase, dispozitivi i aktgjykimin të ankimuar është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyerat e aktgjykimin, në të nuk janë paraqitur arsyeza lidhur me faktet vendimtare, edhe ato pak arsyeza të paraqitura janë në kundërthënie ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimin lidhur me përmbajtjen e shkresave, pastaj, se aktgjykimi bazohet kryesisht në supozime dhe pretendime në aktakuzë, pa marrë në konsideratë mbrojtjen e të akuzuarit, për çka, në mungesë të provave i akuzuari është dashur të lirohet nga akuza. Mirëpo, nga përmbajtja e mëtutjeshme e arsyetimit të ankesës, nuk rezulton të jetë e qartë, konkretisht se cila janë ato shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat janë bërë nga gjykata e shkallës së parë, por në ankesë vetëm në mënyrë të përgjithësuar ka konstatuar se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe atë duke bërë përshtkrimin e dispozitave ligjore të parapara sipas nenit 370 par. 7 të KPPK-së.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore, nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo Gjykatë e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e lartë përmendura ankimore janë të pabazuara, nga se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara nga neni 384 par. 1 nën par.12 të KPPK, nga se dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, kështu që edhe sa i përket përmbajtjes së dispozitivit të aktgjykimit, i njëjti nuk ka asgjë konfuzë dhe se në përmbajtjen e tij janë paraqitur të gjitha veprimet inkriminuese të akuzuarit e që përbëjnë elementet e veprës penale për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor, dispozitiv ky i cili po ashtu nuk është në kundërshtim me arsyetimin, ngase, i njëjti ka mbështetje së pari në provat materiale, si vërtetimi për konfiskimin e armës, pastaj, foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes, por edhe në vetë deklaratën e të akuzuarit, i cili nuk i konteston faktet dhe rrethanat për mënyrën e gjetjes dhe konfiskimit të armës, fakte këto dhe rrethana që janë përshkruar edhe në dispozitiv e që përbëjnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallë fajtor. Po ashtu, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të mjaftueshme mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penale-juridike, po ashtu, janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par. 2 kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par. 7 të KPPK, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyerash i merr i të provuara ose si të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, pra ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë. Prandaj, përveç që qasja ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme as një fakt nuk ka ngelur i pa qartësuar ose i pavërtetuar dhe përveç që janë vërtetuar drejtë ato edhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë. Kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale, dhe atë duke u bazuar në vetë deklaratën e të akuzuarit N.M., i cili nuk i ka mohuar faktet dhe rrethanat përkitazi me mënyrën e gjetjes së armës së zjarrit në shtëpinë ku ka banuar i akuzuari, dhe atë pasi që i njëjti – pra, i akuzuari ka pasur probleme në familjen e tij, pra, është lajmëruar policia për dhunë në familje dhe me të shkuar në shtëpinë e tij, policia ka gjetur armën në katin ku banon i akuzuari me familjen e tij – bashkëshorten dhe vajzën e vogël, edhe atë armën e zjarrit të tipit pushkë M-48, e prodhimit rus me nr. serik 1622, armë kjo, për të cilën vetë i akuzuari personalisht ka pranuar se armën në fjalë e ka poseduar babai që nga koha e para luftës, ndërsa, pas vdekjes së babait të njëjtën e ka mbajtur vetë i akuzuari dhe atë si përkujtim nga babai – tani i ndjeri, që do të thotë se, që nga vdekja e babait të tij, i akuzuari ka qenë personi që e ka poseduar armën në fjalë e jo pjesëtarët tjerë të familjes, sikur që pretendohet nga mbrojtja e të akuzuarit, prandaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare në kuptim të dispozitave të nenit 370 par. 7 të KPPK-së, ngase, përveç fakteve dhe rrethanave jo kontestuese nga vetë i akuzuari gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysh edhe faktet kundërrthënëse, gjegjësisht, pretendimin e mbrojtjes se arma është gjetur në shtëpinë e cila është pronë e përbashkët edhe e vëllezërve tjerë të akuzuarit, fakte këto dhe rrethana që gjykata e shkallës së parë, ka dhënë vlerësimin e saj, përkitazi me këtë, e që konkludimet në fjalë i aprovon edhe kjo gjykatë, prandaj, aktgjykimi i ankimuar edhe në këtë drejtim nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së, sikur që pretendohet në ankesë.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ligjit penal dhe gjetjet e gjykatës.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, me ankesë në esencë kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor

nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë të bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, prandaj edhe përfundimet kanë pasuar të gabuara, pa mbështetje në prova, për çka i akuzuari N.M., është dashur që të lirohet nga akuza e Prokurorisë Themelore- DKR në Gjiilan. Sipas pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë bazë ankimore, pretendohet se gjykata e shkallës së parë, nuk ka marrë fare parasysh deklaratën e të akuzuarit, i cili kategorikisht e ka mohuar kryerjen e veprës penale dhe atë për faktin se shtëpia ku është gjetur arma nuk bëhet fjalë për shtëpinë që është pronë e vetme e të akuzuarit, ngase, e njëjta është pronë e përbashkët edhe e vëllezërve të akuzuarit, të cilët banojnë në atë shtëpi, për çka, konsideron se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje të ligjit penal, kur të akuzuarin e ka shpallë fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë, ngase, nga vetë mbrojtja e të akuzuarit, e që ka mbështetje edhe në provat materiale në shkresa të lëndës, në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar se ditën kritike, pasi më parë në shtëpinë e të akuzuarit gjegjësisht pjesën e shtëpisë – katin e dytë, ku ka banuar i akuzuari me bashkëshorten dhe vajzën e tij, ka shkuar policia për shkak të lajmërimit të rastit të dhunës në familje, me të arritur policia, në pjesën e shtëpisë ku banon i akuzuari së bashku me bashkëshorten dhe vajzën e vogël, ka gjetur dhe konfiskuar armën e zjarrit e tipit pushkë M-48, të cilën e posedon që nga koha kur i ka vdekur babai dhe të njëjtën tani e ruan nga nostalgjia edhe si përkujtim nga babai. Faktet dhe rrethanat në fjalë, gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe përmes provave materiale dhe atë vërtetimin për konfiskimin e armës në fjalë, nga i cili rezulton se vetë i akuzuari personalisht e ka dorëzuar armën në fjalë tek policia, pastaj, foto dokumentacioni në shkresat tjera në lëndë. Ndërsa, përkitazi me faktet kontestuese se arma që është gjetur në shtëpinë që është pronë e përbashkët e të akuzuarit dhe vëllezërve të tij, a është arma e të akuzuarit apo e vëllezërve të tij, gjykata e shkallës së parë, përkitazi me faktet në fjalë, ka marrë parasysh sidomos deklaratën e vetë të akuzuarit, i cili në mbrojtjen e tij ka deklaruar se armën e ka trashëguar nga babai – tani i ndjerë dhe të njëjtën e ka marrë si përkujtim, prandaj, fakti se shtëpia është pronë e përbashkët, është irelevante, ngase, për ekzistimin e veprës penale në fjalë, me rëndësi është posedimi faktik i armës, e jo kush është pronar i shtëpisë apo edhe i armës, sikur që me të drejtë ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e sipër përmendura si dhe rrethanat dhe arsyerat më detajisht të theksuara në aktgjykimin e ankimuar, rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari N.M., është kryes i veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, është i drejtë dhe se në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i akuzuari ka ndër marrë veprimet inkriminuese të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, prandaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, sikur që pretendohet në ankesë.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të të akuzuarit nuk janë të bazuara.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, përkitazi me këtë bazë ankimore theksohet se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është i ashpër, gjegjësisht duke pasur parasysh se nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë, atëherë edhe dënimi nuk është dashur fare të shqiptohet, për çka pretendon se aktgjykimi i ankimuar duhet anuluar ose eventualisht i njëjti

të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit siç parasheh dispozita e nenit 73 të KPK-së. Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit, nuk janë të bazuara nga se rrethanat të cilat ceken me ankesë, të njëjtat janë marrë parasysh nga gjykata e shkallës së parë, dhe asnjëra nga rrethanat e cekura në ankesë nuk janë rrethana të asaj rëndësie që të kenë ndikim në shqiptimin e dënimit më të butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë. Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e konstatuara në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, kontributin e veprimtarisë inkriminuese të akuzuarit, rezulton se dënimin të cilin i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit, dënime me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €, është i drejtë, dhe i ligjshëm, sepse është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, është në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPK.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS
PAKR.504/2018, të dt. 08.11.2018

Procesmbajtësja,
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,

1. Xhevdet Abazi

2. Have Haliti

Kryetari i kolegjit,
Fillim Skoro